

Workshop-i Block III i programit të trajnimit për auditimet e performancës për vendet e Ballkanit Perëndimor dhe Turqisë, organizuar në Vlorë më 4-7 korrik 2023

Në datat 4-7 korrik 2023 u zhvillua në Vlorë workshop-i Block III i programit rajonal për auditimet e performancës për vendet e Ballkanit Perëndimor dhe Turqisë, organizuar nga SAI i Suedisë.

Grupi i auditimit të KLSH-së ka ndërmarrë në kuadër të këtij programi auditimin e performancës me temë *“Shërbimi i Policisë në Përgjigje të Qytetarëve”*.

Prezantimet e ditës së parë u fokusuan mbi ecurinë e deritanishme të auditimeve respektive të secilit SAI nga vendet pjesëmarrëse, si dhe prezantuan nga trajnerët pjesa përshkuese e parastudimit, përkatësisht mbi motivimin e auditimit, përshkrimin e fushës së auditimit, strukturën, problemi i auditimit, problemi social dhe pema e problemit (“problem tree”).



Grupet pjesëmarrëse të auditimeve vijuan me prezantimet e detyrave dhe hapat e përshkruara nga trajnerët në bazë të auditimeve të secilit ekip, si dhe u njohën në vijim me disa faza thelbësore të këtij lloji auditimi si objekti i studimit kryesor, objektivi i auditimit, pyetjet e auditimit dhe kriteret e auditimit.

Përgjatë ditëve të trajnimit u përcaktuan ekipet që do të analizojn punën e grupit të caktuar nga trajnerët për të dhënë sugjerimet mbi përmirësimet e mundshme. Puna në grup për të diskutuar mbi sugjerimet e dhëna nga ekipet vijoi me rekomandimet e ekspertëve suedezë dhe norvegjezë.



Hartimi i auditimit, pyetjet e auditimit dhe kriteret e auditimit ishin tematikat e prezantuara nga trajnerët, të cilat u praktikuan për temën e auditimit të secilit ekip.

Prezantimi i trajnerëve vijoi me shpjegimin e provave të auditimit, metodat për mbledhjen dhe analizën e të dhënave si dëshmi fizike, analiza cilësore dhe sasiore.

Trajnerët dhe ekipet diskutuan mbi metodat e mbledhjes dhe analizës së të dhënave, si dhe konkretisht mbi metodat e mundshme që

secili ekip mund të përdorë për temën e auditimit përkatës.

Në përmbyllje të trajnimit, z. Alfred Zylfi në cilësinë e drejtorit të Departamentit të Auditimit të Performancës, përshëndeti pjesëmarrësit dhe falënderoi organizatorët duke cilësuar se nëpërmjet trajnimit, ekspertët promovojnë më së miri dialogun duke lidhur aspektin teorik me atë praktik për



auditimin e performancës. Kjo mundëson realizimin e një auditimi performance në të gjitha fazat e tij, si dhe zhvillimin e bashkëpunimit, shkëmbimin e përvojave midis kolegëve të SAI-ve, si dhe krijimin e kontakteve të reja në këtë fushë. Kjo është gjithashtu një mundësi për të eksploruar strategjitë e metodologjitë më të fundit të auditimit të performancës me qëllim gjetjen e mënyrave inovative për adresimin e duhur të sfidave që

ndeshen në këtë lloj auditimi.